

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NOTER ELIRA TUSHA
NR. 1032 REP.
NR. 542 KOL.



KONTRATE DHURIMI

Sot, më datë 25/07/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje Elira Tusha, Noter e Dhomës së Noterëve Tiranë me adresë, në Rrugën: "Haxhi Hysen Dalli", Tiranë u paraqitën personalisht:

PALA E I: z.Vladimir Lleshaj, i biri Vlashit, lindur me 08.04.1978 ne Mirdite dhe banues ne Tiranë, i identifikuar prej meje me Leternjoftimin nr. 028424622 dhe nr. personal H80408150T, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *i cili paraqitet në cilësinë e dhuruesit.*

PALA E II: znj. Donika Jaku, e bija e Vlashit, lindur me 22.05.1976 në Rrushkull, Mirdite dhe banuese ne Shkoder, identifikuar prej meje me Leternjoftimin me Nr.027261741 dhe Nr. Personal H65522043Q, *e cila paraqitet në cilësinë e pranuesit te dhurimit.*

Palët e sipërpërmendura, më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Dhurimi, kuotash dhe me vullnetin e tyre, redaktova këtë Kontratë si më poshtë përshkruhet:

TË DHËNA PARAPRAKË

a) Shoqëria "**Big Shkodra**" shpk, ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar ne QKB me 15.08.2016 me Nr. NIPTI L67015003P me seli ne Shkoder, Rruga Faik Konica, kulla 1, lagja Salo Halili (Xhabie).

b) Shoqëria "**Big Shkodra**" shpk ka kapital themeltar të regjistruar në vlerën prej 7.000.000,00 (shtatë milion) lekë, i ndarë në 2 kuota me vlerë kapitali 1 kuotë 3.430.000,00 (tremilionekatërqind e tridhjetë mijë) Lekë dhe një kuotë me vlerë kapitali 3.570.000,00 (tremilion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, nga të cilat:

c) **Ortaku dhurues Vladimir Lleshaj** zotëron 1 kuotë të barabartë me 49 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 3.430.000,00 (tremilionekatërqind e tridhjetë mijë) Lekë dhe

d) ortaku shoqëria **BIGALB GROUP** sh.p.k, zotëron 1 kuote të barabartë me 51 % të kapitalit, me vlerë nominale 3.570.000,00 (tremilion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

Po ashtu, sipas Vendimit nr. 3 date 24.07.2018 Asambleja e Zakonshme e shoqërisë "Big Shkodra" sh.p.k, ka miratuar kërkesën e ortakut Vladimir Lleshaj për dhurimin e 1 kuote me vlerë nominale prej 1.120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) Lekë, e barazvlefshme me 16 % të kapitalit (*Vendimi bashklidhur*).

Te lartpërmendurit, Dhuruesi dhe pranuesi i dhurimit kanë rënë dakord që të lidhin këtë kontratë dhurimi si me poshtë vijon:

NENI 1

Objekti I Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është transferimi i kuotës nëpërmjet dhurimit nga Dhuruesi **Vladimir Lleshaj** tek pranuesit te dhurimit znj. **Donika Jaku** të 1 kuote të barazvlefshme me 16 % të kapitalit të shoqërisë "**Big Shkodra**" shpk, që dhuruesi zotëron në këtë shoqëri me vlerë nominale prej 1.120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) Lekë.

NENI 2

Transferimi I Pronësisë Mbi Kuotat

Pronësia mbi kuotat do të transferohet menjëherë nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Të gjithë të drejtat dhe detyrimet që ai mbante në proporcion me kuoten e dhuruar, do ti kalojnë pranuesit të dhurimit znj. **Donika Jaku**.

NENI 3

Të Ndryshme

Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit se kuotat që transferon nëpërmjet kësaj kontrate janë të lira nga çdo barrë, fakt i cili provohet edhe nga Informacioni i Regjistrimit të Barreve Siguruese. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit **Donika Jaku**, bëhet ortakë e 1 kuote, të barazvlefshme me 16 %, të kapitalit të Shoqërisë "BIG SHKODRA" Shpk me vlerë nominale 1.120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) Lekë.

Pas transferimit të kuotës ortakët e shoqërisë "BIG SHKODRA" sh.p.k do të jenë:

- **Vladimir Lleshaj** zotërues i 1 kuote, e cila përfaqëson 33 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 2.310.000 (dymilion e treqind e dhjetë mijë) Lekë;
- **shoqëria "BIGALB GROUP" sh.p.k**, zotërues i 1 kuote e cila përfaqëson 51 % të kapitalit, me vlerë nominal 3.570.000,00 (tremilion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.
- **Donika Jaku**, zotëruese i 1 kuote, e cila përfaqëson 16 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 1.120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) Lekë.

NENI 4

Baza Ligjore

Kjo kontratë, do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Pjesën IV të tij, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, statutit të shoqërisë si dhe çdo dispozite tjetër ligjore të cilës i bëhet referim në këtë kontratë.

Kontrata hartohet në 4 kopje të barazvlefshme, një kopje e kontratës i jepet palës dhuruese, një kopje për pranuesin e dhurimit, një kopje për depozitim në QKB së bashku me Vendimin e Asamblesë dhe një kopje për arshivën noteriale. Palët pasi e lexuan kontratën, e gjetën konform kërkitit dhe vullnetit të tyre të lirë e nënshkruan në prezencën time pa vërejtje. Unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

PALËT

DHURUESI
VLADIMIR LLESHAJ

PRANUESI I DHURIMIT
DONIKA JAKU

Vladimir Lleshaj

Donika Jaku

NOTER
ELIRA TUSHA




REZULTATET E KËRKIMIT



Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20180725155029347
Data e Rezultatit të Kerkimit: 25.07.2018
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 3:50:29PM
Lloji i Kerkimit:
D-400-686-258
Numri i Dokumentit:
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

VLADIMIR VLASH LLESHAJ
BIG SHKODRA SH.P.K.



Pro Dux